

Në përgjigje të kërkesës së znj. Liza Tushaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, me shkresën nr. 530 prot., datë 16.01.2024, ju informojmë si më poshtë:

Nga verifikimi në sistemin e pagesave të pensione PCAMS, rezulton se Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Lezhë, në zbatim të Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, i ka caktuar znj. Liza Dod Tushaj pension invaliditeti të plotë, të përhershëm, në masën fillestare 11.094 lekë në muaj, me datë lindje të së drejtës 30.03.2006.

Masa fillestare e pensionit ka përfituar rritje gjatë viteve, në zbatim të VKM – ve për rritjen e pensione dhe nga data 01.10.2023, ka arritur në vlerën 17.830 lekë në muaj. Aktualisht e ardhura mujore në pension, përfshirë edhe kompensimet (760 lekë + 648 lekë + 640 lekë + 350 lekë +150 lekë), është në shumën 20.378 lekë në muaj.

Në nenin 62, pika 1, të Ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përcaktohet se: *Personat që kanë të drejtë për më shumë se 1 lloj pensioni, mund të zgjedhin vetëm një prej tyre, kjo e drejtë mund të ushtrohet jo më shumë se tre herë.*

Sa më sipër, nëse znj. Tusha dëshiron të përfitoj pension familjar nga bashkëshorti, ka të drejtë të aplikoj në portalin e-Albania, tek shërbimi: "Aplikim për pension familjar", në zbatim të nenit 41, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, pasi të ketë dorëzuar më parë të gjitha dokumentat për mbylljen e përfitimit të bashkëshortit.

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Lezhë, në bazë të aplikimit, do të kryejë veprimet dhe do të kthejë përgjigje brenda afateve zyrtare, po në portalin e-Albania, në rubrikën "Dokumentat e mia", se cili përfitim do të jetë më i favorshëm për znj. Tushaj.

Ndërkohë, kërkesën për të përfituar shtesën e invaliditetit në shumën 3. 300 lekë, nëse znj. Tusha vendos të përfitoj pensionin familjar, duhet t'ia drejtoje njësisë vendore ku ka të regjistruar vendbanimin, nga e cila e përfiton këtë pagesë aktualisht.

Lidhur me përcaktimin e pagës referuese për profesionin mësuese me arsim të lartë, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 561 datë, 12.08.2005 "Për caktimin e pagave referuese për llogaritjen e pensione para datës 01.01.1994", sipas tablës nr. 2, kodi b.10, merret paga referuese 4.110 lekë, dhe për profesionin mësuese me arsim të mesëm sipas tablës nr. 2, kodi b.11 merret paga referuese 3.507 lekë.

Faleminderit për mirëkuptimin.